



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori k. Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 19 tetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim në lidhje me Kërkesën për Ndryshim Afati të Kërkesës së Mbrojtjes sipas
Rregullës 102(3)**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Pjetër Shalës

Zhan-Lui Zhilisen

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 21(6) dhe 39(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), dhe rregullat 9(5)(a), 76 dhe 95(2)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 19 qershor 2020, në vijim të vendimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,² Prokurori i Specializuar dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar.³
2. Më 16 mars 2021, në vijim të vendimit dhe fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,⁴ Pjetër Shala (“z. Shala”) u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës (“Belgjikë”).⁵

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik u nxorën më 6 maj 2021, F00007/CONF/RED dhe F00007/RED.

³ KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale. Versioni konfidencial me më pak redaktime dhe versioni publik edhe me më pak redaktime i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzuan më 31 mars 2021, F00016/A01 dhe F00016/A02. Një tjetër version konfidencial, edhe me më pak redaktime, i Aktakuzës së Konfirmuar, u dorëzua me 25 maj 2021, F00038/A01.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 12 qershor 2020, konfidencial. Versioni i redaktuar publik doli më 6 maj 2021, F00008/RED. F00008/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për z. Pjetër Shala*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik doli më 15 prill 2021, F00008/A01/RED.

⁵ KSC-BC-2020-04, F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 16 mars 2021, publik.

3. Më 15 prill 2021, me përfundimin e procedurave gjyqësore në Belgjikë, z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë.⁶
4. Më 30 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështjet lidhur me to.⁷
5. Më 3 shtator 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) parashtrori njoftimin e vet në bazë të rregullës 102(3) të Rregullores (“Njoftim sipas Rregullës 102(3)”)⁸
6. Më 14 shtator 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në vijim të një kërkesë nga Mbrojtja e z. Shala (“Mbrojtja”),⁹ e ndryshoi deri më 15 tetor 2021 afatin që Mbrojtja ka në dispozicion për t’i bërë të ditur ZPS-së provat e përmendura në Njoftimin sipas Rregullës 102(3) në të cilat Mbrojtja kërkon të ketë qasje përmes nxjerrjes së provave ose inspektimit (“Kërkesë e Mbrojtjes sipas Rregullës 102(3)”)¹⁰ Gjithashtu, me kërkesë të ZPS-së¹¹, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i ndryshoi si më poshtë afatet që Prokuroria ka në dispozicion lidhur me Kërkesën e Mbrojtjes sipas Rregullës 102(3): (i) në rast se do të kundërshtojë rëndësinë materiale të provave që do të përmenden në Kërkesën e Mbrojtjes sipas Rregullës 102(3), ZPS-ja duhet t’i drejtohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake jo më vonë se 29 tetor 2021 (ose brenda dy javësh nga Kërkesa e Mbrojtjes sipas Rregullës 102(3); (ii) ZPS-ja duhet t’i nxjerrë Mbrojtjes ose t’i sigurojë qasje në materiale të zgjedhura që nuk kanë nevojë të redaktohen jo më vonë se 12 nëntor 2021 (ose brenda 4 javësh nga Kërkesa e Mbrojtjes sipas Rregullës 102(3);

⁶ KSC-BC-2020-04, F00019, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit*, 15 prill 2021, konfidencial, para. 2, me shtojcat 1-2, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik doli më 26 prill 2021, F00019/RED.

⁷ KSC-BC-2020-04, F00033, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështjet lidhur me to*, 30 prill 2021, publik.

⁸ KSC-BC-2020-04, F00069, Prokurori i Specializuar, *Njoftim sipas Rregullës 102(3) i Prokurorisë me Shtojcën konfidenciale 1*, 3 shtator 2021, publik, me një shtojcë, konfidenciale.

⁹ KSC-BC-2020-04, F00074, Mbrojtësi i Specializuar, *Mocioni i Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit të Kërkesës së saj sipas Rregullës 102(2)*, 9 shtator 2021, publik.

¹⁰ KSC-BC-2020-04, F00078, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesat lidhur me Ndryshimin e Afateve dhe Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Tretë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrimet*, 14 shtator 2021, publik (“Vendimi i 14 shtatorit 2021”), para. 16, 26(a).

¹¹ KSC-BC-2020-04, F00076, Prokurori i Specializuar, *Përgjigjja e Prokurorisë për KSC-BC-2020-04/F00074 dhe Kërkesë për Modifikimin e Afateve të lidhura me të*, 10 shtator 2021, publik.

dhe (iii) ZPS-ja duhet të nxjerrë materiale që kanë nevojë për redaktime standarde ose të parashtrorë çdo kërkesë për redaktime jostandarde /masa mbrojtëse për materialin e zgjedhur jo më vonë se data 26 nëntor 2021 (ose brenda 6 javësh nga Kërkesa e Mbrojtjes sipas Rregullës 102(3)).¹²

7. Më 22 shtator 2021, the ZPS-ja parashtrorë Njoftimin shtesë sipas Rregullës 102(3).¹³

8. Më 23 shtator 2021, gjatë konferencës së tretë për ecurinë e çështjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ndër të tjera, ndryshoi afatet që ZPS-ja ka në dispozicion për parashtrimin e dosjes së procedurës paraprake deri më 28 janar 2022, dhe për parashtrimin e tabelës sipas rregullës 109(c) deri më 11 shkurt 2022.¹⁴

9. Më 13 tetor 2021, Mbrojtja kërkoi ndryshimin e afatit për Kërkesën e vet sipas Rregullës 102(3) deri në 2 javë nga data kur ZPS-ja të ketë paraqitur hollësi të mjaftueshme për të gjitha provat e renditura në Njoftimin sipas Rregullës 102(3) ("Kërkesa").¹⁵ Sipas Mbrojtjes, asaj i nevojitet kohë shtesë duke pasur parasysh numrin e konsiderueshëm të provave të reja të identifikuar në Njoftimin shtesë sipas Rregullës 102(3) si dhe mungesën e informacionit të mjaftueshëm lidhur me numrin e madh të provave të renditura atje.¹⁶ Mbrojtja parashtron se ka arsye të vlefshme për ndryshimin e kërkuar pasi koha shtesë do t'i mundësonte Mbrojtjes që të përpunonte informacionin e dhënë në Njoftimin fillestar dhe shtesë sipas Rregullës 102(3), të mund të kërkonte nga ZPS-ja të gjitha sqarimet e nevojshme *inter partes*, si dhe të paraqiste një qëndrim të bazuar në informacion lidhur me provat që kërkon.¹⁷ Mbrojtja

¹² Vendimi i 14 shtatorit 2021, para. 19, 26(b).

¹³ KSC-BC-2020-04, F00082, Prokurori i Specializuar, *Njoftim Shtesë i Prokurorisë sipas Rregullës 102(3)*, 22 shtator 2021, publik, me një shtojcë, konfidencial.

¹⁴ KSC-BC-2020-04, Transkript, 23 shtator 2021, publik, f. 92, rreshti 10-20.

¹⁵ KSC-BC-2020-04, F00086, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit të Kërkesës së saj sipas Rregullës 102(2) [sic]*, 13 tetor 2021, publik, para. 1, 13, 15. Referimin e rregullës 102(2) të Rregullores prej Mbrojtjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e kupton si kërkesë të Mbrojtjes për ndryshim të afatit lidhur me kërkesën e saj drejtuar ZPS-së bazuar në rregullën 102(3) të Rregullores.

¹⁶ Kërkesa, para. 13.

¹⁷ Kërkesa, para. 14.

shton se është ende në pritje të përgjigjes ndaj kërkesës së vet për hollësi lidhur me 1000 provat e renditura në Njoftimin sipas Rregullës 102(3).¹⁸

10. Më 15 tetor 2021, ZPS-ja iu përgjigj Kërkesës (“Përgjigja”).¹⁹ ZPS-ja bën të ditur se nuk e kundërshton Kërkesën dhe thotë më tej se brenda datës 28 tetor 2021 parashikon që të japë informacionin shtesë të kërkuar nga Mbrojtja për disa prova të Njoftimit sipas Rregullës 102(3).²⁰

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

11. Në pajtim me nenin 21(6) Ligjit, të gjitha provat ose faktet juridikisht thelbësore dhe relevante që i posedon ZPS-ja të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit vihen në dispozicion të të akuzuarit para fillimit të procesit dhe gjatë tij, dhe u nënshtrohen vetëm atyre kufizimeve që janë rreptësisht të nevojshme dhe atëherë kur zbatohen mbrojtjet e nevojshme kundërbalancuese

12. Në bazë të rregullës 9(5)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *proprio motu*, ose nëse i tregohen arsye të vlefshme, mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje.

13. Në bazë të rregullës 76 të Rregullores, kërkesa për zgjatje të afatit paraqitet në kohë, për t’i lënë panelit kohë të mjaftueshme për marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën para përfundimit të afatit përkatës.

14. Në bazë të rregullës 95(2)(b) të Rregullores, pas paraqitjes së parë të të akuzuarit sipas rregullës 92 të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcakton afate për nxjerrjen e provave, merr masa për të mundësuar nxjerrjen e materialeve në kohë dhe përgatit një raport për trupin gjykues mbi nxjerrjen e materialeve.

¹⁸ Kërkesa, para. 7-11, 14.

¹⁹ KSC-BC-2020-04, F00087, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Zgjatje Afati*, 15 tetor 2021, publik.

²⁰ Përgjigja, para. 1.

III. DISKUTIM

15. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se janë dëshmuar arsye të vlefshme, të cilat përlligjin ndryshimin e kërkuar, dhe që lidhen me numrin e konsiderueshëm të provave të përfshira në Njoftimin shtesë sipas Rregullës 102(3) dhe kërkesën ende pa përgjigje të Mbrojtjes për informacion të mëtejshëm lidhur me disa prova të renditura në Njoftimin sipas Rregullës 102(3). Gjithashtu, ZPS-ja nuk e kundërshton ndryshimin e kërkuar. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton më tej se Kërkesa është dorëzuar mjaftueshëm përpara kalimit të afatit në shqyrtim, konkretisht dy ditë përpara përmbushjes së afatit fillestar.²¹ Duke vërejtur se ZPS-ja ka bërë të ditur se do ta japë informacionin shtesë të kërkuar nga Mbrojtja jo më vonë se 22 tetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizon Mbrojtjen që të paraqesë Kërkesën sipas Rregullës 102(3) jo më vonë se 5 nëntor 2021.

16. Duke pasur parasysh ndryshimin e autorizuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se duhen zgjatur po ashtu edhe afatet në dispozicion të ZPS-së lidhur me Kërkesën e Mbrojtjes sipas Rregullës 102(3). Rrjedhimisht, ZPS-ja është e detyruar që: (i) t'i drejtohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake jo më vonë se 19 nëntor 2021 (ose brenda dy javësh nga Kërkesa e Mbrojtjes sipas Rregullës 102(3) në rast se synon të kundërshtojë rëndësinë materiale të provave të renditura në Kërkesën e Mbrojtjes sipas Rregullës 102(3); (ii) të nxjerrë për Mbrojtjen ose t'i japë qasje asaj në materialet e zgjedhura që nuk kanë nevojë për redaktime jo më vonë se 3 dhjetor 2021 (ose brenda 4 javësh nga Kërkesa e Mbrojtjes sipas Rregullës 102(3)); dhe (iii) të nxjerrë materialet që kanë nevojë për redaktime standarde ose të parashtrojë çdo kërkesë për redaktime jostandarde /masa mbrojtëse për materialin e zgjedhur jo më vonë se 17 dhjetor 2021

²¹ Gjithsesi palët inkurajohen që kërkesa të tilla në të ardhmen t'i parashtrojnë disa ditë përpara përfundimit të afatit në mënyrë që t'i mundësojnë palës kundërshtare për t'u përgjigjur dhe t'i mundësojnë Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të shpallë vendimin përpara kalimit të afatit për të cilin kërkohet ndryshimi.

(ose brenda 6 javësh nga Kërkesa e Mbrojtjes sipas Rregullës 102(3).²² Këto ndryshime nuk cenojnë afatet për paraqitjen e dosjes paraprake dhe të tabelës sipas rregullës 109(c), prej ZPS-së.

17. Në rast se palët mendojnë se afatet lidhur me nxjerrjen e materialit sipas rregullës 102(3) duhen ndryshuar më tej, ato duhet t'i parashtrojnë këto kërkesa përpara konferencës së ardhshme për ecurinë e çështjes të datës 15 nëntor 2021.²³

²² ZPS-ja inkurajohet që kërkesat për redaktime jostandarde /masa mbrojtëse t'i parashtrojë në kohë të mjaftueshme përpara afatit dhe jo në ditën e fundit të tij, në mënyrë që të mundësohet trajtimi i papenguar i kërkesave dhe i nxjerrjeve vijuese.

²³ KSC-BC-2020-04, Transkript, 23 shtator 2021, publik, f. 102, rreshti 8-18.

IV. VENDIM

18. Bazuar në arsyet e mësipërme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) **MIRATON** Kërkesën dhe **URDHËRON** Mbrojtjen që të paraqesë Kërkesën sipas Rregullës 102(3) jo më vonë se **të premten, 5 nëntor 2021**; dhe
- (b) **URDHËRON** ZPS-në që: (i) t'i drejtohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake jo më vonë se **të premten, 19 nëntor 2021** (ose brenda dy javësh nga Kërkesa e Mbrojtjes sipas Rregullës 102(2) në rast se synon të kundërshtojë rëndësinë materiale të provave që do të përmenden në Kërkesën e Mbrojtjes sipas Rregullës 102(3)); (ii) të nxjerrë për Mbrojtjen ose t'i japë qasje në materialet e zgjedhura që nuk kanë nevojë për redaktime jo më vonë se **të premten, 3 dhjetor 2021** (ose brenda 4 javësh nga Kërkesa e Mbrojtjes sipas Rregullës 102(3)); dhe (iii) të nxjerrë materialet që kanë nevojë për redaktime standarde ose të paraqesë çdo kërkesë për redaktime jostandarde/masa mbrojtëse për materialin e zgjedhur jo më vonë se **ditën e premte, 17 dhjetor 2021** (ose brenda 6 javësh nga Kërkesa e Mbrojtjes sipas Rregullës 102(3)).

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E martë, 19 tetor 2021

Hagë, Holandë.